



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 86 Datë 29. 07. 2008**

**Për mos klasifikimin si përqendrim të bashkimit me përthithje të shoqërive CT Telekom dhe Albtelekom Sh.a**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Perpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2008, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje ndërmjet shoqërive CT Telekom dhe Albtelekom”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” neni 25.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë CT Telekom nga Albtelekom,

**V Ë R E N S E:**

**Palët pjesëmarrëse** të përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në transaksion:

**1. Albtelekom SHA**, shoqëria përthithëse është rregjistruar në rregjistrin tregtar me Vendimin Nr 20820, datë 16 shkurt 1999 dhe përbëhet nga dy aksionerë:

- a) CT Telekom sha- 76% të kapitalit; dhe
- b) Shteti Shqiptar, përfaqësuar nga METE- 24% të kapitalit.

**2. Shoqëria CT Telekom ShA**, shoqëria e përthithur, e krijuar dhe që vepron në përputhje me Ligjin nr 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, rregjistruar në Qendrën Kombëtare të rregjistrimit në Tiranë, Shqipëri me certifikatën SN-000506-09-07, datë 21.09.2007.

Aksioneri i vetëm 100% i shoqërisë CT Telekom sh a (shoqëri bijë), është shoqëria Çetel Telekom (shoqëria mëmë).

Shoqëria CT Telekom ShA, shoqëria e përthithur, zotërohet 100% nga nga shoqëria Cetel Telekom.

**Palët e përfshira në mënyrë të tërthortë në transaksion dhe lidhjet ndërmjet tyre:**

**3. Cetel Telekom**, shoqëri anonime e themeluar dhe e krijuar më 18 qershor 2007 sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, me kapital të përbërë 20% nga Turk Telekom dhe 80% Cetel Calik Energi. Cetel Telekom zotëron në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet bijës së saj, 76% të kapitalit dhe të së drejtës së votës në shoqërinë Albtelekom.

Shoqëria CETEL Telekom ka blerë 76% të aksioneve në shoqërinë Albtelekom, duke përftuar paketën mazhoritare të kontrollit në të. Transaksioni është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr 54, datë 4.09.2007.

Për realizimin e këtij transaksioni, shoqëria Çetel Telekom, themeloi shoqërinë CT Telekom, të zotëruar direkt nga Cetel Telekom<sup>(1)</sup>. Qëllimi i krijimit dhe objekti i veprimtarisë së CT Telekom ishte realizimi i përftimit të kontrollit për pjesën 76% të kapitalit në shoqërinë Albtelekom sha.

### **Përshkrimi i transaksionit**

Aksionerët e Albtekomit, me datën 17 korrik 2008 kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkimit me përthithje, ku Albtelekom është shoqëria përthithëse dhe CT Telekom shoqëria e përthithur, i

<sup>1</sup> Kontrata për blerjen e aksioneve (KBA), Neni 8, paragraf 8.3 dhe 8.4- Titulli i pronësisë mbi aksionet.

parashikuar edhe në kontratën e shitblerjes së aksioneve të permendur më lart. Pas realizimit të bashkimit me përthithje CT Telekom, i cili deri tani ka zotëruar 76% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në shoqërinë Albtelekom sha do të pushojë së ekzistuari dhe Cetel Telekom, shoqëria mëmë, do të marri në zotërim 76% të aksioneve të Albtelekomit, ndërsa shteti shqiptar, i përfaqësuar nga METE do të mbajë 24% të aksioneve të shoqërisë Albtelekom ShA.

Transaksioni i realizimit të bashkimit me përthithje ndërmjet shoqërive Albtelekom Sha dhe CT Telekom sha nuk ndryshon formën ligjore të njësisë që rezulton pas përqendrimit, duke mos sjellë asnjë ndryshim në kapitalin aksionar dhe të së drejtës së votës brenda shoqërisë Albtelekom SHA. , që do të thotë pa shkaktuar ndryshime në cilësinë e kontrollit.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 25 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,

### **VENDOSI:**

1. Të mos klasifikojë njoftimin për “Bashkimin me përthithje të shoqërisë CT Telekom nga Albtelekom Sh.a”, si përqendrim në zbatim të neneve 10 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Lush Përpali**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**